

Syllabusi i lëndës

Lënda: Tefsir I - *Studime mbi Kur`anin*

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 7 ECTS

Niveli dhe lloji i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 107

Fondi i orëve: 3+3

VITI AKADEMIK :2015/2016

Semestri: -II-

Mësimdhënësi: Prof. ass. dr. Xhabir Hamiti

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Lënda “ Hyrje n shkencat e Kur`anit “ është fushë e studimit mbi Kur`anin e cila i qaset atij që nga zanafilla e tij e parë si: shpallja, format e receptimit të Kur`anit nga ana e Pejgamberit Muhammed .a.s, memorizimi i tij nga ana e besimtarëve, shkrimi dhe evidentimi i tij përmes mjeteve të kohës, deri në momentin e tubimit të Kur`anit në një koleksion zyrtar. Përveç anës historike mbi librin e shenjtë, kjo lëndë përmban edhe hulumtimin mbi përmbajtjen e tij, ndarjen dhe radhitjen kronologjike, opinionet e studiuesve të Lindjes dhe të Perëndimit për çështje dhe problematika të ndryshme krahasuese mbi Kur`anin etj., që nga ato klasike deri tek koha e sotme bashkëkohore.

Qëllimi i lëndës:

Që studentët të pajisen me njohuri të rëndësishme mbi Kura`ani duke filluar nga struktura përbërëse e tij si; domethënia e fjalës Kur`ani në aspektin etimologjik dhe terminologjik, emrat e Kur`anit, forma dhe mënyra e shpalljes deri tek përmyllja e shpalljes dhe kodifikimi i tij në një koleksion.

Studentët përmes kësaj materie do të pasurohen me njohuri argumentuese dhe shkencore përmes së cilave ata do të mund të diskutojnë dhe të mbrojnë të vërtetën e Kur`anit si libër të shenjtë të cilin e pasojnë sot rreth 1/3 e njerëzve në botë.

Krahas studimit mbi Kur`anin studentët përmes kësaj lënde do të njihen edhe me njohuri elementare mbi librat e tjerë hyjnor kryesor të ithtarëve të librave si Tevrati dhe Inxhili(Dhiata e vjetër dhe Dhiata e Re) .

Gjatë mësimit të kësaj lënde studentët po ashtu do të kenë mundësi të debatojnë si dhe të nxisin diskutime rreth çështjeve të cilat e ndërldhin hyjnësinë e librave qiellore dhe ato të cilat i ndajnë ato.

Vijuesi i këtij subjekti njashu do të studioj edhe mendimet e historianëve dhe orientalistëve të ndryshëm botëror mbi Kur`anin , qasjet dhe analizat e tyre ndaj librit të shenjtë Kuranit.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi student do të jete në gjendje:

- Të përshkruajnë zanafillën e Kur`anit – fillimin e shpalljes së tij deri te etapa e kodifikimi i tij në një koleksion.
- Të bëjnë krahasimin e librit të shenjtë Kur`anit me librat tjerët hyjnorë të cilat i përmend në brendësinë e tij edhe vet Kur`ani.
- Të diskutojnë lidhje mbi dhe rreth ndarjes së Kur`anit në ajete, fjali dhe kaptina dhe në ndarje të tjera të cilat i kanë definuar studiuesit e Kuranit
- Të mbrojnë shenjtërinë e Kuranit dhe të librave të tjerë hyjnorë me argumente shkencore dhe analitike.
- Të zhvillojë dhe prezantojë mendim kritik lidhje me tematika të cilat ndërlidhen me Kuranin.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, nxitjes së studentëve për debat dhe diskutime interaktive, përmes seminareve dhe hulumtimit të literaturës së re e cila lidhet ngushtë me natyrën e lëndës. Do të bëhen edhe teste vlerësuese të kohëpaskohshme dhe punë grupore me studentë për tema të caktuara.

Përmbajtja e lëndës:

Java e pare: Hyrje dhe në lëndën e studimeve kuranore. Njoftim me plan programin e lëndës-syllabusin, metodologjinë dhe formën e zhvillimit të ligjëratave dhe vlerësimit të studentëve. Zanafilla e studimeve kuranore, definimi etimologjik dhe terminologjik i studimeve mbi Kuranin, studiuesit dhe librat e hershëm klasik të studimeve mbi Kur`anin dhe të atyre bashkëkohor. Studiuesit më të njohur shqiptar për Kuranin dhe veprat e tyre të njohura deri më tani.

Literatura: Prof.Dr. Enes Kariç “ Hyrje në shkencat e Tefsirit”, f. 19-47 si dhe tekste nga disertacioni i doktoratures :” Studimet e shqiptareve mbi Kuranin ne shekullin XX-të, të mbrojtur në Universitetin e Sarajevës në vitin 2008, nga kandidati Xhabir Hamiti

Java e dyte: Definicionet e Kur`anit: linguistike, terminologjike, definicionet e ekzegjesës dhe të legjislaturës islame, kuptimi i revelatës- vahjit, emrat e Kur`anit.

Literatura: Ahmed fon Denfer, Historia e Kur`anit, fq. 20- 30

Java e tretë: Forma e Kur`anit, suret si kaptina dhe emrat e tyre, ajetet si fjali të Kur`anit, besmelja si invokacion në Kur`an, pastaj të ashtuquajturat “ shkronja misterioze” ose “fillimet e sureve”.

Literatura: Hyrje në shkencat e Tefsirit, Enes Kariç, f.75-119

Java e katërt: Tubimi i Kur`anit, shkrimi dhe memorizimi i tij në kohën e Muhmmedit a.s. Zanafilla e Kur`anit gjatë kohës së Kalifit Ebu Bekrit. Kodifikimi në kohën e Kalifit Othman ibn Affanit dhe shumëzimi i Mus-hafit-kopjes origjinale të Kur`anit. Kopjet personale të Mus-hafit tek sahabinjët e caktuar. Dorëshkrimet e Kuranit të vjetra –ultra teksti i tyre .

Literatura: Hyrje në shkencat e Tefsirit , Enes Kariç, f. 121-139

Java e peste:Vokalizimi i arketipit kur`anor, bashkëtingëlloret e arketipit kur`anor

Literatura: Prof.dr. Enes Kariç, : “ Sit ë komentohet Kur`ani” f. 81-123

Java e gjashtë: Stilizimet e kur`anit, konsekuencat hermeneutiko-filozofike të çiltërsisë dhe mbylltësisë së Kur`anit.

Literatura: Prof.dr. Enes Kariç, “ Si të komentohet Kur`ani” f.123-135

Java e shtatë: Ndarja e Kuranit në dy etapa kryesore kohore; mekas dhe medinas, kriterët e ndarjes së Kuranit në mekas dhe medinas,karakteristikat e njohjes së ajeteve mekase dhe medinase, dobia shkencore e njohjes së kësaj ndarje për studiuesit dhe komentuesit e Kur`anit.

Literatura: Ahmed fon Denfer, Historia e Kur`anit, f. 97-103

Java e tetë: Çështja e abrogimit- pezullimit të ajeteve në Kur`an, polemika mes dijetarëve islame rreth çështjes së abrogimit, format e abrogimit, rëndësia e njohjes së e tematikës mbi abrogimin në Kur`an.

Literatura: Xhabir Hamiti,” Studime kur`anore” fq. 87-100

Java e nëntë: Gjuha e Kuranit, stili, ekzistojnë apo nuk ekzistojnë fjalë të huaja në Kur`an, karakteristikat e stilit kur`anor.

Literatura: Hyrje në shkencat e Tefsirit , Enes Kariç, f.171-178

Java e dhjetë: Shkaqet e zbritjes së ajeteve në Kur`an, rëndësia e njohjes së shkaqeve të shpalljes, kriteret e njohjes së shkaqeve të zbritjes në Kur`an, raporti i tekstit dhe shkakut të shpalljes.

Literatura: Hyrje në shkencat e Tefsirit , Enes Kariç, f.183-193

Java e njëmbëdhjete: Shembujt në Kur`an, llojet e shembujve, rëndësia e njohjes së shembujve në Kur`an, ilustrimet në Kur`an sipas shembujve”.

Literatura: Menaa el- Kattan, “Mebahith fi ulumil Kur`an”, f.291-299

Java e dymbëdhjetë: Renditja e ajeteve dhe kaptinave në Kur`an, forma e renditjes, kush e ka renditur Kur`anin në formën të cilën ai e ka sot, a ka pas ndërhyrje nga dora e njeriut në renditjen e Kur`anit!.

Literatura: Menaa el- Kattan, “Mebahith fi ulumil Kur`an”, f.135-146

Java e trembëdhjetë: Mrekullia e Kur`anit, definicioni i mrekullisë së Kur`anit, etapat e sfidimit, mrekullia stilistike dhe shkencore e Kur`anit.

Literatura: Prof.dr. Fadel Hasen Abbas, “Itkanul-burhan fi ulumil-Kur`an”, f. 107-120

Java e katrëmbdhjetë: Pse Muhammedi a.s. nuk ishte autor i Kur`anit, por vetëm ndërmjetësues? Kush e etikonë Muhammedin si autor të Kur`anit? Cfar thotë Kur`ani lidhje me këtë. Sa janë të vjetra shpifjet rreth kësaj çështjeje?

Literatura: Prof.dr. Fadel Hasen Abbas, “Itkanul-burhan fi ulumil-Kur`an”, f. 89.120

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjeratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura obliguese :

1. Ahmed fon Denfer, “Historia e Kur`anit”, Tiranë, 2006
2. Prof. Enes Kariç ” Hyrje në shkencat e Tefsirit “,Prishtinë, 1996
3. Prof.dr. Enes Kariç, “ Si të komentohet Kur`ani”, Prishtinë,2008
- 4.Xhabir Hamiti, “ Studime kuranore” Prishtinë, 2001

Literatura opsionale:

- 1 .Andrew Rupin&Frithojf Schoun, “ Kurani dhe komentimi i tekstit Kuranor”, Drita, Gjilan 2008
2. Farid Esack “ The Qur`an a user’s guide”, Oxford , 2005
3. Malik Ibn Nebi, “ Fenomeni uranor” Prishtinw, 1998
4. Bediuzzeman send Nursi, “ Mrekullia e Kur`anit” Gostivar, 2003
5. Ingrid Mattson, “ The story of the Qur`an”, Malden – USA, 2008

